



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 157, datë 18.05.2021

**PËR CAKTIMIN ME SHORT TË DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË
POSAÇËM PËR PROCEDURËN E PLOTËSIMIT TË DY VENDEVE VAKANTE
PËR PROKURORË NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 159 pika 2 germa “i”, 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “ç” dhe 190 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, nenin 11 pika 2 e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, miratuar me vendim nr. 51, datë 19.03.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin me short të dy anëtarëve për procedurën e plotësimit të dy vendeve vakante për prokurorë në prokurorinë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si më poshtë:

- Anëtar nga radhët e prokurorëve Z. Bujar Sheshi;
- Anëtar nga radhët e jo prokurorëve Znj. Nurihan Seiti;

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

